



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 856 Prot.

Tiranë, më 29 /08/2016

VENDIM

Nr. 54, datë 29/8 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 856 Prot., datë 11.08.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me emailin e datës 26.07.2016 ka kërkuar nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë t'i vihet në dispozicion *kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Institucionin e Presidencës duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar*.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjisllacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Z. _____ është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Informacioni mbi organikën e stafit që punon në Institucionin e Presidencës, rolin, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare si dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës një përshkrim të strukturës organizative, funksionin, dhe detyrat e autoritetit publik.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. _____ ndaj Autoritetit Publik/ *Institucionit i Presidentit të Republikës së Shqipërisë*, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012

‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____, Nr. 856 Prot., datë 11.08.2016, ndaj Autoritetit Publik/Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për vënie në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Institucionin e Presidencës duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar), brenda datës 05.09.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 29. 8.2016.


Besnik DERVISHI
KOMISIONERI